EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

INFORMATIONAL BULLETIN

3 TETOR 2014

Mandati i ri Këshillit Konsultativ për Komunitete: Sfidat dhe Mundësitë

Autor: Trim Kabashi

Redaktor: Nicola Brassil

Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllimin e gjithëmbarshëm të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe forcon kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të bashkëvepruar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

1. Hyrje

Pas një procesi njëmujor të nominimit dhe akredimit të anëtarëve të rinj, Kryetarja e Republikës së Kosovës, Z. Atifete Jahjaga, më 30 Qershor 2014 emëroi anëtarët e rinj të Këshillit Konsultativ për Komunitete (KKK) për një mandat dy-vjeçar. Ky do të jetë mandati i tretë i KKK-se pas mandatit me kohëzgjatje 2010-2012 dhe atij 2012-2014. KKK-ja e ka origjinën si një grup joformal i themeluar në vitin 2005 si pjesë e delegacionit të Kosovës në bisedimet për statusin me Serbinë në Vienë. Pas Shpalljes së Pavaresisë së Kosovës, dhe në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës të propozuar nga i Dërguari i Posaçëm i OKB-së Marti Ahtisaari, ekzistenca e KKK-së u formalizua si një trup i përhershëm kushtetues me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.[1]

Pamje nga takimi inaugurues i Këshillit Konsultativ për Komunitete, i kryesuar nga Kryetarja Atifete Jahjaga (11 Shtator 2014).
Fotografia nga: Këshilli Konsultativ për Komunitete



Për gjashtëmbëdhjetë (16), apo 67%, nga njëzetekatër (24) anëtaret e caktuar ky është mandati i parë si anetarë të Këshillit. Anëtaret e rinj si dhe komunitetet dhe organizatat prej nga janë nominuar janë të prezentuara në Tabelen 1 (shih faqen numër 34). Zyra e Kryeministrit si dhe Zyra e Kryetarit të Kosovës nuk i kanë caktuar anëtarët e tyre ende. Këshilli mbajti takimin inaugurues që u kryesua nga Kryetarja Jahjaga, më 11 Shtator 2014. Në seancen e rradhës të mbajtur më 25 Shtator, Këshilli zgjodhi Kryesuesin dhe dy zv. Kryesuesit e vet.

[1] Për më shumë informata ju lutem shihni këtu: http://ëëë.ccc-rks.net/index.php/perne/historia

Darko Dimitrijević (komuniteti serb) u zgjodh Kryesues për një mandat një-vjeçar, ndërsa **Fergap Zaimi** (komuniteti goran) dhe **Josip Blaško** (komuniteti kroat) u zgjodhën zv. Kryesues.

Në fjalimin e saj para anëtarëve të sapo emëruar në takimin inaugurues, Kryetarja Jahjaga e nënvizoi rëndësine e Këshillit dhe mandatit të tij siç definohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ligjet relevante. Jahjaga pohoi se Kosova duhet të përforcojë marrëdhëniet e saj me komunitetet dhe të punojë për krijimin e një shoqërie tolerante që i pranon të gjithë anetaret e saj pavarësisht nga origjina e tyre etnike, dhe ku anëtaret e komuniteteve mund të identifikohen jo vetëm me komunitetin e tyre po edhe si qytetarë të lirë dhe të barabartë të Kosovës. Këshilli Konsultativ e luan një rol vendimtar në këtë proces si një institucion kushtetues që shërben për shkëmbimin e ideve në mes të komuniteteve dhe institucioneve të Kosovës në pergjithesi, si dhe është një platformë nga ku komunitetet mund të luftojnë për të drejtat e tyre, tha ajo. Kryetarja Jahjaga i bëri thirrje KKK-së që të jetë edhe më i zëshëm në zbatimin e mandatit të vet,jo vetëm për komunitetet si komunitete, po edhe si qytetarë të barabartë të Kosovës.

***Table 1*: Pasqyrë e anëtarëve të Këshillit dhe organizatave / komuniteteve që ata i përfaqësojnë[2]**

Komuniteti / Organizata	Emri	Anëtar/e i/e ri/e
Serb	Darko Dimitrijević Saša Petrović Jelena Kostić Slobodan Mitić Dušan Radaković	√ √ √ √ √
Turk	Esin Şişko, Agim Rifat Taner Güçlütürk	√ √
Boshnjak	Isak Meta Amela Radončić Mejdin Saliji	√ √
Rom	Bashkim Ibishi Avni Mustafa	
Ashkali	Bekim Syla Belkize Islami	√
Egjiptian	Lendrit Qeli Adem Abazaj	√ √
Goran	Emrin Zurapi Fergap Zaimi	√
Malazez	Branka Stamenković Radoman Doderović	√ √
Kroat	Josip Blaško Sebastijan Čolakić	√
Ministria për Komunitete dhe Kthim	Srećko Bogajčević	
Zyra e Kryetarit	Ende nuk është emëruar	Ende nuk është emëruar
Zyra e Kryeministrit	Ende nuk është emëruar	Ende nuk është emëruar

[2] Ju lutem shihni Aneksin 1 për një biografi të shkurtë të anëtarëve

2. Arritjet dhe Sfidat

Themeluar me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës më 15 shtator 2008 në bazë të nenit 60 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 12 të Ligjit për Komunitete në Kosovë, mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete është për të vepruar si një mekanizëm për shkëmbimin e ideve mes komuniteteve të ndryshme të Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Siç specifikohet me *Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë*, buxheti i KKK-së duhet të mundësojë që ai të angazhohet në mënyrë efektive në studime dhe anketa, të marrë këshilla të jashtme nga ekspertët përkatës, të angazhohet në ndërtimin e kapaciteteve të anëtarëve të saj dhe organizatave të tjera të komunitetit përkatës përfaqësues, të kryejë programe përkatëse që kanë të bëjnë me çështjet e komuniteteve në Kosovë, dhe të caktojë pjesë të buxhetit të saj në organizatat përfaqësuese të komuniteteve, OJQ-ve, dhe aktorëve të tjerë në mbështetje të projekteve të KKK-së.[3] Kësisoji, është e një rëndësie të veçantë për KKK-në që ta ketë një buxhet të mjaftueshem së bashku me mbështetjen strukturore që asaj i nevojitet (financiare, ligjore, teknike) që të ketë sukses në përmbushjen e detyrës së vet kushtetuese. Një buletin informativ i publikuar nga ECMI Kosova në qershor të vitit 2013 ka përshkruar hollësisht se si mangësite në ndarjen e buxhetit për KKK-në pengojnë seriozisht aftësite e Këshillit për të përmbushur mandatin e vet kushtetues.[4] Buxheti i KKK-së për vitet 2012 dhe 2013 ishte vetëm 87,385 euro, dhe nga kjo shumë, vetëm 60,000 euro tepruan pas shpenzimeve për funksionimin e Sekretariatit të KKK-së. Në këtë mënyre, zhvillimi i programeve nga ana e KKK-së frenohet dhe mandati i Këshillit mbetet i papërmbushur. KKK-ja është përballur me mungesa te tilla buxhetore gjatë gjithë mandatit të vet dhe do të vazhdojë te përballet me to edhe në të ardhmen e afërt.[5]

Megjithatë, edhe pse vendimet e Këshillit nuk janë ligjërisht detyruese dhe pa marrë parasysh burimet modeste buxhetore, Këshilli Konsultativ për Komunitete ka pasur disa suksese të dukshme në zbatimin e mandatit të tij dhe në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve të Kosovës. Rekomandimet e Keshillit drejtuar disa ministrive të caktuara kanë prodhuar rezultate konkrete. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për shembull, i

[3] Neni 12.11 & 12.13; *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Neni 60.
[4] https://ecmikosova.org/the-budget-of-the-ccc/
[5] KKK-ja, e mbështetur nga ECMI Kosova, vazhdimisht ka kërkuar nga autoritetet përkatëse rritje të buxhetit të saj. Kërkesat e KKK-se asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje pozitive.

është përgjigjur pozitivisht rekomandimit të Këshillit që t'i furnizojë nxënësit jo-shqiptarë që donë ta mësojne gjuhën shqipe si gjuhë të dyte me libra në gjuhën shqipe. Për më tepër, Ministria e Bujqësisë ka zgjatur afatin e disa konkurseve për pune pasi ka marrë një rekomandim nga Këshilli që t'i publikojë konkurset edhe në gjuhët e komuniteteve. KKK-ja gjithashtu ka kryer hulumtime dhe nxjerrë rekomandime mbi kuotat e rezervuara për studentët nga rradhët e komuniteteve jo-shqiptare në universitetet publike; hulumtime dhe rekomandime për nivelin e punësimit të komuniteteve jo-shqiptare në institucionet dhe agjencionet e ndryshme publike; hulumtime dhe rekomandime për strehimin dhe ndihmën sociale ndaj atyre anëtarëve të komuniteteve jo-shqiptare të riatdhesuara me forcë në Kosovë; hulumtime dhe rekomandime për çështjen e nostrifikimit të diplomave të anëtareve të komuniteteve jo-shqiptare që ka ndikim në mundësitë e tyre për punësim në institucionet publike, etj.

Hulumtimi mbi nivelin e punësimit të komuniteteve jo-shumicë në institucionet publike ka ngritur çështjen e perspektives se kufizuar të punësimit të të diplomuarve nga "Universiteti i Mitrovicës / Mitrovicë Veriore (UMN)" për shkak të statusit të paqartë ligjor të universitetit. Meqë shumica e studentëve të universitetit vijnë kryesisht nga pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë dhe një pjesë e madhe e komuniteteve jo-shumicë të Kosovës vijojnë arsimin e lartë në UMN, kjo çështje prek komunitetet jo-shumicë në veçanti. Rekomandimi I KKK-së për çështjen e diplomave ka sjellë krijimin e një Ekipi të Qeverisë përgjegjës për të ardhur deri te një zgjidhje që do të lejojë të diplomuarit nga UMN për të aplikuar për punë në institucione publike të Republikës së Kosovës.

3. Mbështetja dhënë KKK-se nga ana e ECMI Kosova[6]

Mbështetja nga ECMI Kosova për Këshillin filloi me themelimin e Këshillit dhe është mbështetje e gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Faza e tanishme e mbështetjes përfshin ndryshimin e Statutit të KKK-së, Rregulloren e Punës, kompensimin financiar, aktet e brendshme që rregullojnë Sekretariatin, si dhe mbështetje të gjerë në fushat programore të Këshillit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe ngritjes së vetëdijes së publikut për KKK-në dhe

[6] ECMI Kosova ka mbështetur punën e Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe të Sekretariatit si pjesë e projektit "Mbështetje për Anëtarët e Shoqërisë Civile të Këshillit Konsultativ për Komunitete", financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë në Kosovë.

rëndësinë që e ka Këshilli nëpërmjet prodhimit të broshurave informative, si dhe videoklipeve informuese që janë transmetuar në media lokale dhe kombëtare, si dhe i janë shpërndarë partnerëve dhe bashkëpunëtorëve të ECMI Kosovës.

Që nga formimi, por sidomos në vitet e fundit të funksionimit të vet, Këshilli është mbështetur kryesisht në ndihmë të jashtme në mënyrë që të funksionojë dhe të përmbushë pjesë të mandatit të vet. Për shkak të kufizimeve ekstreme të buxhetit dhe stafit të kufizuar, KKK dhe Sekretariatit i tij nuk janë në gjendje për të siguruar ato trajnime dhe atë mbështetje që shumë i nevojitet anëtarëve të KKK-së.

Anëtarët kanë një mandat relativisht të shkurtër (dy vjet) dhe shumë nga ta nuk e kanë prapavijën ligjore/teknike që do t'ia mundësonte atyre për të shqyrtuar dhe komentuar me kompetencë mbi legjislacionin dhe politikat e ndryshme. Për këtë arsye, anëtaret kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme teknike dhe ligjore për t'i formësuar mendimet e tyre dhe marrë vendime pas informimit adekuat. Megjithatë, pa rritje të buxhetit, Këshilli nuk do të jetë në gjendje që të rrisë numrin e stafit apo të financojë aktivitete të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe anëtarëve.

4. Përfundim

Në mënyre që të ketë sukses, Këshilli Konsultativ për Komunitete ka nevojë për strukturat e veta mbështetese (financiare, ligjore, teknike). Deri në ditën e sotme, puna e Këshillit është mbështetur me anë të financimit të jashtëm, i kanalizuar nëpërmjet ECMI Kosovës. Financimi i jashtëm është ofruar nga qeveritë e Gjermanisë, Zvicrës, Britanisë së Madhe, Norvegjisë, me mbështetje shtesë nga OSBE dhe Këshilli i Evropës.

Pas gjashtë vitesh ekzistencë, dhe duke qenë një nga institucionet e pakta të mandatuara nga Kushtetuta që mirren me cështje të minoriteteve, është koha që Këshillit t'i sigurohet një buxhet adekuat nga ana e Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit. Buxheti aktual është rreth gjashtëdhjetemijë euro (60,000) dhe këtu përfshihen shpenzimet për meditje dhe seanca plenare. Ky buxhet nuk i plotëson as nevojat themelore të Keshillit; në fakt, buxheti vështirë se e lejon Këshillin që t'i mbuloje shpenzimet e punës. Këshillit duhet t'i alokohet një buxhet që ia mundëson atij përmbushjen e mandatit të vet kushtetues. Institucione tjera publike që mirren

më çështje të komuniteteve, siç janë Zyra për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit apo Zyret Komunale për Komunitete dhe Kthim në përgjithesi nuk ballafaqohen me probleme të tilla buxhetore.

Aneksi 1

Darko Dimitrijević përfaqëson komunitetin serb dhe është një reporter i ri në "Radio Goraždevac" si dhe aktivist nga fshati Gorazhdec në komunën e Pejës. Dimitrijeviq u propozua nga OJQ "Experimental Sound" nga Gorazhdeci . Ai është anëtar për herë të parë i KKK-së, dhe u zgjodh kryetar i KKK-së për një mandat një-vjeçar më 25 shtator 2014.

Sasha Petrović përfaqëson komunitetin serb dhe është një aktivist nga fshati Gorazhdec në komunën e Pejës. Petroviq është nominuar nga OJQ "Experimental Sound" nga Gorazhdec. Ai është anëtar për herë të parë i KKK-së.

Jelena Kostić përfaqëson komunitetin serb dhe është nga rajoni i Gjilanit. Ka qenë aktive në OJQ të ndryshme në atë rajon. Ajo është anëtare për herë të parë e KKK-së.

Slobodan Mitić përfaqëson komunitetin serb dhe është një aktivist i ri nga rajoni i Gjilanit. Ka qenë aktiv në disa OJQ në atë zonë. Ai është anëtar për herë të parë i KKK-së.

Dushan Radaković përfaqëson komunitetin serb dhe është një aktivist nga Komuna e Mitrovicës së Veriut. Ai është anëtar për herë të parë i KKK-së.

Isak Meta përfaqëson komunitetin boshnjak dhe ka qenë kreu i Këshillit Boshnjak të Kosovës. Ai është një aktivist i kalitur në jetën civile dhe politike të Kosovës. Është anëtar për herë të parë i KKK-së.

Amela Radončić përfaqëson komunitetin boshnjak dhe është një aktiviste e re nga rajoni i Pejës. Ajo ishte kandidate për zgjedhjet e asamblesë lokale në Pejë nga koalicioni VAKAT në vitin 2013. Ajo është anëtare për herë të parë e KKK-së.

Mejdin Saliji përfaqëson komunitetin boshnjak dhe është një nga themeluesit e Këshillit Boshnjak të Kosovës si dhe profesor i matematikës në rajonin e Pejës. Ai është gjithashtu themelues i Këshillit të Kongresit të Intelektualëve boshnjakë në Kosovë, një OJQ që merret me çështje që i përkasin komunitetit boshnjak në Kosovë. Ky është mandati i tij i dytë si anëtar i KKK-së.

Esin Şişko përfaqëson komunitetin turk dhe punon në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në seksionin e diversitetit kulturor dhe dialogu. Poashtu ka qenë edhe anëtare e Komisionit të Publikimeve në po atë ministri. Ajo është anëtare për herë të parë e KKK-së.

Taner Güçlütürk përfaqëson komunitetin turk dhe është një aktivist civil i kalitur. Z. Güçlütürk mban doktoraturë në gjuhë dhe letërsi turke. Ai ka punuar edhe si gazetar dhe moderator në media të ndryshme në gjuhën turke në Kosovë. Ky është mandati i tij i dytë, meqë ka shërbyer më parë gjatë mandatit 2012-2014.

Agim Rifat përfaqëson komunitetin turk dhe është një aktivist që më parë ka qenë edhe gazetar në media të ndryshme në gjuhën turke me bazë në Prizren. Ai mban diplomë nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës. Është anëtar për herë të parë i KKK-së.

Bashkim Ibishi përfaqëson komunitetin rom dhe është një aktivist i kalitur civil si dhe Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Kosovare për Avokim dhe Zhvillim. Ky është mandati i tij i dytë si anëtar ne KKK meqë ka shërbyer më parë gjatë mandatit 2012-2014.

Avni Mustafa përfaqëson komunitetin rom. Ai ka qenë aktiv në OJQ-në "Romaino Resipe" dhe aktualisht është anëtar i OJQ-së "Balkan Sunfloëers". Ai është një aktivist i të drejtave të njeriut. Ky është mandati i tij i dytë si anëtar ne KKK meqë ka shërbyer më parë gjatë mandatit 2012-2014.

Lendrit Qeli përfaqëson komunitetin egjiptian dhe është një aktivist i ri nga rajoni i Gjakovës. Ai është aktiv në "Radio Prosperiteti", një radio lokale në Gjakovë. Është anëtar për herë të parë i KKK-së.

Adem Abazaj përfaqëson komunitetin egjiptian dhe është një koordinator në OJQ-në "PIRAMIDA 2011" që mirret me çështje të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Është anëtar për herë të parë i KKK-së.

Bekim Syla përfaqëson komunitetin ashkali dhe është një aktivist i vjetër i të drejtave të njeriut si dhe Drejtor i “Roma-Ashkali Documentation Center” (Qendra për Dokumentimin e Romëve-Ashkalive). Është anëtar për herë të parë i KKK-së.

Belkize Islami përfaqëson komunitetin ashkali. Ajo ka punuar si praktikante në Kuvendin e Kosovës në kuadër të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim. Ajo mban një diplomë në Inxhinieri Mekanike nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj. Ky është mandati i saj i dytë si anëtare e KKK-së meqë ka shërbyer më parë gjatë mandatit 2012-2014.

Fergap Zaimi përfaqëson komunitetin goran dhe është një aktivist për çështje gorane si dhe mësues nga rajoni i Dragashit në Kosovën jugore. Si anëtar i KKK-së nga 2012-2014, ai shërbeu në Grupin Punues të KKK-së për Legjislacion. Ai u zgjodh zëvendëskryesues i KKK-së për një mandat një-vjeçar më 25 shtator 2014. Ky është mandati i tij i dytë si anëtar i KKK-së.

Emrin Zurapi përfaqëson komunitetin goran dhe është një aktivist i ri nga rajoni i Dragashi në Kosovën jugore. Është anëtar për herë të parë i KKK-së.

Branka Stamenković përfaqëson komunitetin malazez. Ajo është anëtare për herë të parë e KKK-së.

Radoman Doderović, përfaqësues i komunitetit malazez, ka shërbyer si këshilltar për çështje ekonomike dhe zhvillimin në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, dhe është një aktivist i kalitur politik dhe civil i komunitetit malazez në Kosovë. Është anëtar për herë të parë i KKK-së.

Josip Blaško përfaqëson komunitetin kroat. Ai ka qenë anëtar i KKK-së gjatë mandatit 2012-2014 dhe, në këtë cilësi, ai shërbeu në Grupin Punues të KKK-së për Legjislacion. Ai është nga Janjeva, fshat me shumicë kroate në komunën e Lipjanit. Ai u zgjodh zëvendëskryesues i KKK-së për një mandat një-vjeçar më 25 shtator 2014.

Sebastijan Čolakić përfaqëson komunitetin kroat dhe është një aktivist nga Janjeva, fshat me shumicë kroate në komunën e Lipjanit. Ai poashtu është anëtar i Këshillit të Kroacisë për kroatët jashtë Kroacisë si përfaqësues i komunitetit kroat në Kosovë. Është anëtar për herë të parë i KKK-së.

Srećko Bogajčević përfaqëson Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthim ne rolin e tij si Shef i Kabinetit në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Ai është ekonomist i diplomuar dhe më parë ka punuar në OSBE në komunën e Shtërpcës. Ky është mandati i tij i dytë si anëtar i KKK.